

**Dt 22 .12.2011 botuar e plote ne gazeten Telegraf**  
**Ç'FARË DUHET NDRYSHUAR NË POLITIKËN E BE PËR TË PËRAFRUAR PRANIMIN E**  
**SHQIPËRISË**

**Letër publike ambasadorit të BE në Tiranë - zotit Ettore SEQUI –**

I nderuar zoti Ambasador,

E vlerësojmë personin tuaj, zoti ambasador, pasi për shkak të kohës që ju po punoni në Shqipëri njihni shumë mirë shqetësimet reale të shoqërisë shqiptare dhe anarkinë e pronës të shkaktuara nga mungesa e dëshirës së politikanëve për të respektuar të drejtën e pronësisë konform detyrimeve kushtetuese dhe kërkesave të dok nr 11115 dt 20 Dhjetor 9006 të Asamblesë Parlamentare të KE.

Është fakt se pas 1991 çifti politik Sali Berisha - Fatos Nano devijuan nga rruga drejt Europës dhe janë përgjegjësit e zbatimit të këtij skenari që ka ruajtur thelbin e sistemit komunist duke e maskuar atë me pluralizmin partiak. Ata, përzien korrupsion dhe disa elemente të çrregullt të ekonomisë së tregut, miratuan ligje që shkelin të drejtën e pronësisë dhe Kushtetutën, duke u kujdesur për ta penguar kthimin fizik të pronës tek i zoti. Por ky sistem klanor dhe nepotik, që shkel haptas të drejtat e njeriut, ka pasur mbështetjen morale dhe financiare të Bashkimit Europian, të B. Botërore dhe USAID. Ju dhe të gjithë ambasadorët jeni në dijeni të faktit se prej kohësh Agjencia e Kthimit të Pronave, funksion si institucion që pengon kthimin e pronës tek i zoti dhe se në këto 20 vjet, për konflikte të pronës, janë raportuar 8000 krime dhe se mbi 60% e proceseve gjyqësore i përkasin pronave, se vendimet gjyqësore nuk ekzekutohen dhe po ashtu dhe vendimet e Gjykatës së Strasburgut nuk ekzekutohen dhe përsëri heshtje. Ju lutemi na thoni kur do mbarojë kjo heshtje vrasëse. Delegacioni i BE që u takua me përfaqësuesit e Qeverisë për problemet e moszekutimit të vendimeve të gjykatës së Strasburgut në 15 dhe 16 Dhjetor 2011 në Tiranë u mjaftua vetëm me relacionet e palës qeveritare dhe shmangu ballafaqimin me kryesinë e Shoqatës tonë. Pse ky qëndrim kur tashmë është e qartë se e vetmja pengesë për ta kthyer pronën tek i zoti është mungesa absolute e vullnetit politik. **Po përsërisim sjellim shembuj të retorikës demagogjike të lidërshit të politikës shqiptare: z.Sali Berisha, në 16 Shtator 2010 në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me pronën ka deklaruar: “...një përballje midis mafies grabitqare të tokave në këtë vend dhe pronarëve të mjerë, të cilët gjatë këtyre viteve panë tentakulat e pushtetit të shtrihen drejt tokave të tyre drejt pronave të tyre”, “Një amalgamë pushtetarësh grabitës me pseudopronarë, që kanë grabitur dhe vëllezërit e tyre, me fallsifikime monstruoze e me ndihmën e pushtetarëve kanë lënë duar bosh pronarët e vërtetë“ ..... “Beteja për pronën është beteja për sistemin. Beteja për stabilizimin e pronës është beteja për stabilizimin e kapitalizmit në Shqipëri. Absolutisht.”.** Për të gjithë është e qartë se prona nuk mund të

**stabilizohet me kompensime, pasi kjo kërkon që paraprakisht neni i kushtetutës që thotë se ..prona fitohet me blerje me dhurim dhe me trashëgimi të ndryshojë dhe të bëhet: prona fitohet me grabitje me thëhim me legalizim ...**

Zoti Edi Rama kryetar i opozitës së fundmi ka deklaruar se këto 20 vjet politika është talluar me pronarët e ligjshëm. Me dt 11 Dhjetor 2011 po ai kritikoi publikisht klanet mafioze, ndërtimet e kundralishme dhe vendimet e gjyqësorit në zonën turistike të Sarandës dhe flakë për flakë z. Berisha në intervistën TV me dt 16.12 2011, deklaroi vazhdimin dhe zgjerimin e legalizimit të ndërtimeve pa leje. Praktikisht z. Sali Berisha as që mendon për respektim të të drejtave të njeriut dhe sistemin kapitalist kujton se mund ta ndërtojë pa respektuar të drejtën e pronës së trashëguar.

Gjykatat i riciklojnë pronarët nga shkalla e parë në të dytën dhe përsëri i rikthejnë në të parën, duke i zgjatur me vite proceset për pronat dhe padrejtësitë ndaj pronarëve lidhen ngushtë me korrupsionin e sistemit të drejtësisë dhe të administratës. Vrasjet e shumta për probleme të pronës dhe rastet e fundit të ekzekutimit makabër të gjyqtarit S.Konomi në Vlorë dhe pas tij vrasja në Durrës e oficerit të SHIK-ut që hetonte problemet e pronave janë sinjale alarmi të vërtetë. .... Përditë pronarët e ligjshëm po llogaritin se e vetmja mundësi për të marrë pronat e trashëguara janë Gjykata e Strasburgut ose vetgjyqësia.

Nga disa deklarata të zotit Fyle të znj. Ashton dhe ndërkombëtarëve të tjerë kuptojmë se Ata nuk janë në dijeni të plotë të dimensioneve dhe të rrezikshmërisë së anakisë së pronës në Shqipëri dhe të këqijat që i ka sjellë popullit qëndrimi antipronar i lidërsipit politik prej 20 vjetësh.

Ndërkombëtarët nuk kanë kuptuar se në këto 20 vjet politikanët kanë qenë të interesuar vetëm për pushtetin dhe për të akumuluar sa më shpejt dhe sa më shumë pasuri për sa kohë do të jenë në pushtet. Ndërkombëtarët nuk kanë të qartë se asgjë nga 12 pikat nuk do përparojë nëse më parë nuk kthehet prona tek i zoti dhe se kompensimi është demagogji. Nëse ju zoti Etoë Sequi, nëpërmjet strukturave të BE do të angazhoheni seriozisht për zgjidhjen me prioritet të problemit të pronës, keni për të parë se kërkesat e tjera shumë shpejt do zgjidhin njera tjetrën.

Ne mendojmë se nga ndërkombëtarët është gabuar dhe po gabohet me këtë qëndrim të butë dhe të vakët dhe me mënyrën pasive të kërkesës për kthimin tek pronarët e ligjshëm të pronës private të grabitur . Ky proces duhet të fillojë me bllokimin urgjent të procesit të legalizimeve dhe kompensimeve pa përcaktuar më parë të drejtën e pronësisë mbi tokën, pavarësisht nga zëri kadastral. Pastaj duke bërë shfrytëzimin e arkivave dhe regjistrimin e plotë të pasurive të pajuahtëshme sipas dokumentave të shtetëzimit që në vitin 1945 dhe të

gjitha këto dokumenta Shteti i ka në arkiva. Po ashtu duhet të jetë detyrim i Shtetit të regjistrojë pronat që në vitin 1945 figurojnë të ishin prona private dhe të regjistrohen pronat që i përkisnin shtetit dhe tokat që janë krijuar në periudhën 45 vjeçari 1945-990. Këto sipërfaqe dalin dhe teprojnë për të bërë kompensimin fizik për pronat e tjetërsuara deri në 1991 për godina banimi dhe pronat që vazhdojnë të shfrytëzohen për nevoja publike.

**Zyrtarët e lartë të Bashkimit European: Baronessa Catherine Ashton, z. Stafan Fyle, ambasadorët dhe drejtorët e Bankës Botërore, FMN dhe USAID, krahas lidërshiptit politik shqiptar mbajnë përgjegjësi për jetët e humbura nga vrasjet për shkak të pronës. Nëse ndërkombëtarët do vazhdojnë vetëm të ndjekin me vëmendje progresin e mardhëniesve PD-PS, populli do vazhdojë të jetojë dhe të vuajë në gërmadhën e komunizmit. Demokracia do mund të vijëvetëm nëpërmjet kushtëzimit përfshi edhe të fondeve që ndërkombëtarët japin për Shqipërinë. Kushtëzimi duhet të përcaktojë afate të shpejta që politikanët ti japin fund talljes me parimet themelore të demokracisë dhe qëndrimit të deritanishëm që ka lejuar shkeljen e të drejtës së pronës së trashëguar.**

Në pritje të përgjigjes publike, shpreh besim në mirëkuptimin tuaj.

Rrapo Hajredin Danushi

Kryetar i shoqatës kombëtare të shoqatës

“Pronësi me Drejtësi”